



Operatori i Sistemit të Transmetimit

OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT
DREJTORIA E PROKURIMEVE

Nr. _____ prot.

Tiranë, më ____ . ____ . 2021

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Nga: Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.)

Adresa: Tiranë, Kashar, Yrshek, Autostrada Tiranë-Durrës, Km. 9

Kontakt: www.ost.al; e-mail: info@ost.al.

Për: OE “Pastrime Silvio sh.p.k”, me NIPT K91413010N

Adresa: Rruga “Fatmir Haxhiu” (prapa ETC), Tiranë.

Procedura e prokurimit: “Procedurë e hapur” - me mjete elektronike – Shërbime

Numri i referencës i procedurës: REF-76470-10-22-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Shërbimi i pastrimit dhe gjelbërimit për godinën qendrore të OST sh.a.”.

Kohëzgjatja e kontratës: 12 (dymbëdhjetë) muaj nga hyrja në fuqi e kontratës.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike, Datë 26.10.2020, Nr. 91.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët.

Fondi Limit: 14,000,000 (katërbëdhjetë milion) Lekë pa TVSH, nga të ardhurat e OST sh.a.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: Datë 16.11.2020.

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë 3 (tre) ofertues, me vlerat përkatëse të ofruara:

- 1. OE “Clean Fast” sh.p.k.** me NIPT L61807037R
me ofertë ekonomike 12,685,000 (dymbëdhjetë milion e gjashtëqind e tetëdhjetë e pesë mijë) Lekë Pa TVSH.
- 2. OE “Pastrime Silvio” sh.p.k.** me NIPT K91413010N

me ofertë ekonomike 13,802,550 (trembëdhjetë milion e tetëqind e dy mijë e pesëqind e pesëdhjetë) Lekë pa TVSH.

3. OE “Alpest” sh.p.k.
pa ofertë ekonomike.

me **NIPT M01714005H**

Nuk janë kualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. OE “Alpest” sh.p.k., me NIPT M01714005H, për arsye se:

Nuk ka paraqitur asnjë dokument sipas DST.

2. OE “Clean Fast” sh.p.k., me NIPT L61807037R, për arsye se:

➤ Nuk ka përmbushur pikën 2.3.10, “Për kapacitetin teknik” të kriterëve të veçanta të kualifikimit ku parashikohet se: *“Operatori ekonomik ofertues, ditën dhe orën e caktuar për hapjen e ofertave duhet të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor nga një mostër për artikujt që do të përdoren gjatë kryerjes së shërbimit.....” sepse:*

i) OE Clean Fast ka paraqitur mostrat në Orën 10:00 të datës 16/11/2020 (pasqyruar dhe në procesverbalin e datës 16.11.2020), por në listen e mostrave mungojnë disa prej produkteve, konkretisht:

- a. *Solucioni për Pastrimin e Dyshemeve industriale* (artikulli Nr.20) dhe në vend të tij është dorëzuar një solucion për dysheme jo industrial.
- b. Gjithashtu mungon dhe artikulli 21, *Solucion për dysheme të trajtuar/lyer resinë* dhe në vend të tij është sjellë solucion për pastrim sipërfaqesh metalike.
- c. Produkti nr.24 *Solucion për pastrim kompiuterash* nuk është fare dhe në vend të tij është sjellë solucion për pastrimin e tavolinave të punës.
- d. Si dhe *qeset e mbeturinave* produktet Nr.16 dhe 17 nuk janë sipas litrave (nxënësisë) të kërkuara (bashkangjitur do të gjeni kopje të procesverbalit të nënshkruar rregullisht nga palët prezent).

➤ Nuk ka përmbushur pikën 1/e të kriterëve të veçanta të kualifikimit, në lidhje me shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik sepse:

i) ka paraqitur vërtetim nga OSHEE vetëm në lidhje me kontratën me kod TR1B1.....561. Mirëpo referuar Ekstraktit Historik lëshuar nga QKB, Clean Fast sh.p.k. ka vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit në adresën: Njësia Bashkiake Nr. 9, Rruga Fortuzi, Apartamenti në katin e parë, Pasuria me Nr.5/209+1-2, ZK. 8350, për të cilën nuk ka vërtetim nga OSHEE për shlyerjen e energjisë elektrike.

- Nuk ka përmbushur pikën 2.3.5, “Për kapacitetin teknik” të kriterëve të veçanta të kualifikimit pasi dy nga certifikatat ISO të dorëzuara nuk janë në përputhje me Objektin e Prokurimit sepse nuk është e specifikuar “Për ambientet e gjelbërta”. Konkretisht ISO 14001: dhe ISO 18001:.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **OE “Pastrime Silvio” sh.p.k.** me **NIPT K91413010N**, me adresë: Rruga “Fatmir Haxhiu” (prapa ETC), Tiranë, për vlerën **13,802,550 (trembëdhjetë milion e tetëqind e dy mijë e pesëqind e pesëdhjetë) Lekë pa TVSH**, se është identifikuar si ofertë e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqisni pranë Drejtorisë së Prokurimeve të OST sh.a., me adresë *Tiranë, Kashar, Yrshek, Autostrada Tiranë -Durrës, Km 9*, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentet e tenderit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të procedohet siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 26.11.2020.

Ankesa: Po.

Vendimi i KSHA-së Nr. 7209/3 Prot., datë 04.12.2020.

Vendimi i KPP-së Nr. 31/2021, datë 21.01.2021.

ADMINISTRATOR I OST SH.A.

Skerdi Drenova